

BIZNESI SHQIPTAR ALBANIAN BUSINESS

QENDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM TIRANË
CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

Rr. "Luigj Gurakuqi",
P. 15/1, Shk. 1, Ap. 1
PO. Box 218/1 Tirana

Tel & Fax (0)4 230 445
Mobile: (0)68 20 67 630
E-mail: info@qkzh.org

www.qkzh.org

Rezultatet e vrojtit të
biznesit dhe konsumatorëve
Nr. 20, qershor 2006



*Business and Consumer
Survey Results
No 20, June 2006*

INDUSTRIA PËRPUNUESE

MANUFACTURING SECTOR


Treguesi i besueshmërisë së biznesit në sektorin e industrisë përpunuese në muajin Prill 2006 shënon një rritje prej 6 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë. Rritja e treguesit të besueshmërisë në këtë tremujor ka ardhur kryesisht nga rritja e parashikimeve për prodhimin në 3 muajt e ardhshëm, ndërsa niveli i kontraktimeve shënon rënie duke mbetur në nivele negative. Megjithatë, shkalla e optimizmit të këtij sektori është më e ulët krahasuar me një dhe dy vjet më parë duke treguar se kemi një dobësi të biznesit në sektorin e industrisë përpunuese.

Më mirë paraqitet situata në nëndegët e industrisë përpunuese, si industria e fabrikimit të artikujve prej druri, mobiljeve, tekstileve dhe këpucëve, ndërsa me dobet paraqitet situata në industrinë e produkteve ushqimore dhe materialeve të ndërtimit.

Kërkesa e pamjaftueshme dhe mangësitë e legjislacionit fiskal janë faktorët kryesorë kufizues në sektorin e industrisë prodhuese, ndërkohë që ndikimi negativ i energjisë elektrike po vjen duke u zvogëluar.

Në anketimin e fundit të prill 06, **treguesi i besueshmërisë**, ka kaluar në nivel pozitiv prej 4 pikësh duke treguar për një rritje të optimizmit të drejtuesve të firmave prodhuese për tremujorin në vazhdim. Rritja e

FIGURA 1: Treguesi i QKZH për besueshmërinë në industrinë përpunuese
CRD Confidence indicator in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

treguesit të besueshmërisë me 6 pikë në krahasim me balancën në përqindje për të njëjtin tregues në janar 2006 ka ardhur si rezultat i rritjes së parashikimit të aktivitetit të biznesit. Ky nivel është 9 pikë në përqindje më e ulët se balanca e këtij treguesi të një viti më parë dhe 11 pikë më e ulët se dy vite më parë dhe përbën kështu vlerën e dytë më të ulët të së njëjtës periudhë nga vëzhgimet 3 vjeçare. Niveli aktual i këtij treguesi tregon se aktiviteti prodhues në 3 mujorin e dytë të këtij viti do të jetë një periudhë e favorshme për biznesin në këtë sektor.

Klima e biznesit sipas sektorëve në industrinë përpunuese

Duke bërë analizën e nëndegëve të vecanta të industrisë përpunuese treguesi i QKZH për besueshmërinë në industrinë e fabrikimit të artikujve minerale jometalike ka pësuar rritje nga -33 pikë në janar 2006 në 23 pikë për anketimin e fundit. Kjo tendencë në rritje tregon për një periudhë të favorshme në tremujorin në vazhdim të kësaj nëndege të industrisë përpunuese. Në dy nëndegët e tjera, atë të industrisë së kartonit, botimeve, kimike kauçukut dhe plastikës, rafinimit të naftës dhe koksifikimi si dhe industrisë së punimit të metaleve, metalurgjisë, fabrikimi i makinave, pajisjeve dhe pjesëve të ndërrimit etj treguesi i QKZH për besueshmërinë ka pësuar rënie përkatësisht me 9 dhe 2 pikë në përqindje.

Industria ushqimore, pijeve dhe duhanit ka një përmirësim të këtij treguesi pavaresisht se në vlera negative, nga -19 pikë në -5 pikë. Industria e fabrikimit të artikujve prej druri, mobiljeve etj . ka një përmirësim të dukshëm me 34 pikë në përqindje duke kaluar nga niveli negativ i 28 pikëve në nivelin pozitiv prej 6 pikësh për këtë tregues (shiko figurën 3). Optimizmi i drejtuesve të kësaj nëndege të industrisë përpunuese lidhet me rritjen sezonale të prodhimit në industrinë e fabrikimit të artikujve prej druri, mobiljeve etj. Për sa i përket treguesit të besueshmërisë në industrinë e tekstileve, veshjes dhe lëkurë këpucëve, ka pësuar një rënie të lehtë në krahasim me tremujorin e parë të 2006 por që vazhdon të qëndrojë në nivele pozitive përgjatë gjithë periudhës së anketimit 2002-2006.

Parashikimi i aktivitetit të prodhimit

Sipas parashikimeve të biznesmeneve të këtij sektori pritet një rritje e aktivitetit të biznesit për tremujorin në vazhdim e reflektuar në vlerën prej 35 pikësh dhe shënon një rritje prej 32 pikësh në përqindje në krahasim me 3 muajt e kaluar, duke dhënë një ndikim të drejtëpërdrejtë në rritjen e treguesit të besueshmërisë. Balanca e përgjigjeve për prill 2006 është 21 pikë në përqindje më e ulët krahasuar me një vit më parë ku ky tregues kap dhe vlerën më të lartë historike të periudhës së anketimit, ndërsa e krahasuar me mesataren 2002-2005 është 11 pikë në përqindje më e lartë. .

Niveli i kontraktimeve

Vlerësimi mbi nivelin aktual të kontraktimeve në sektorin e industrisë përpunuese në anketimin e fundit prill 2006 shënon rënie duke mbetur në nivele negative sikurse ka qenë për të gjithë periudhën e mëparshme janar 2002– janar 2006. Figura 5 tregon se balanca e përgjigjeve për nivelin e kontraktimeve është -35 pikë. Kjo vlerë është 8 pikë më e ulët se vlerësimi i kontraktimeve për tremujorin e kaluar dhe ruan gati të njëjtin nivel me një vit më parë. Krahasuar me mesataren 2002-2005 rënia e treguesit të vlerësimit të nivelit të kontraktimeve, kap vlerën e 11 pikëve të balancës në përqindje.

FIGURA 2: Treguesi i QKZH për besueshmërinë sipas degëve të industrisë përpunuese
CRD Confidence indicator in manufacturing branches




FIGURA 3: Treguesi i QKZH për besueshmërinë sipas degëve të industrisë përpunuese
CRD Confidence indicator in manufacturing branches






FIGURA 4: Parashikimi i aktivitetit të biznesit në industrinë përpunuese
Expectation of business activity in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 5: Vlerësimi i nivelit të kontraktimeve në industrinë përpunuese
Assesment of order-books in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Gjendja e produkteve të gatshme

Balanca e përgjigjeve për gjendjen e produkteve të gatshme në muajin prill 2006 (shiko figurën 6) tregon nivelin negativ prej 11 pikësh i cili është vetëm 2 pikë në përqindje më i lartë se 3 muaj më parë. Vlerësimi mbi produktin e gatshëm për prill 2006 është përkatësisht 8 pikë në përqindje më i lartë se një vit më parë dhe 14 pikë në përqindje më i lartë se mesatarja 2002-2005. Ky tregues ka shënuar rritje duke treguar se tendenca e drejtuesve të firmave prodhuese për rritjen nivelit të produktit të gatshëm lidhet me parashikimet e tyre për një situatë optimiste në këtë sektor. Megjithëse balanca e përgjigjeve është negative, nuk ka ndikuar në uljen e besueshmërisë së biznesit.

Aktiviteti i prodhimit në 3muajt e kaluar


Manaxherët e firmave të intervistuar vlerësojnë aktivitetin e prodhimit në 3 muajt e kaluar me ritme më të ulta rritjeje. Nga figura 7 shikohet se në muajin prill 2006 balanca në përqindje e përgjigjeve të këtij treguesi është 4 pikë, duke pësuar një rënie me 11 pikësh në përqindje në krahasim me tre muaj më parë. Ky tregues për prill 2006 është 36 pikë në përqindje më i lartë krahasuar me një vit më parë, vit në cilin ky tregues ka vlerën më të ulët historike. Krahasuar me prill 2004 vlerësimi i aktivitetit të prodhimit në anketimin e fundit është 32 pikë në përqindje më i lartë. Po kështu ky nivel është i njëjtë me mesataren 3 vjecare.

Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese

Kapacitetet prodhuese në industrinë përpunuese në bazë të të dhënave të anketimit të prill 2006 janë shfrytëzuar në masën prej 65%. Ky nivel është gati i njëjtë me tremujorin e fundit duke treguar për nivele të qëndrueshme të këtij treguesi. Treguesi i paraqitur në figurën 8 është rreth 2 dhe 14 pikë në përqindje më i lartë përkatësisht se një vit dhe dy vjet më parë. Përgjigjet e anketimit të fundit tregojnë se shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese është 6 pikë në përqindje më e lartë se mesatarja e periudhës 3 vjecare 2002-2005.


Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë e letrës, botimeve, kimike, kauçikut, rafinerimit të naftës dhe koksifikimit për periudhën 2002-2006 (shiko figurën 9) ka luhatjen më të madhe të vlerave në përqindje. Vlerën maksimale në përqindje për gjithë periudhën e anketimit vazhdon ta ketë industria e tekstileve dhe lëkure këpucëve me 83% si dhe vlerën aktuale më të lartë me 82%. Industria ushqimore, pijeve dhe duhanit ka diferencën më të ulët midis vlerës maksimale dhe minimale gjatë gjithë periudhës 2002-2006, duke treguar për qëndrueshmërinë e këtij treguesi në këtë nëndegë të industrisë përpunuese.

FIGURA 6: Vlerësimi i produkteve të gatshme në industrinë përpunuese
Assesment of stocks in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 7: Vlerësimi i aktivitetit të prodhimit në industrinë përpunuese në 3 muajt e kaluar
Assesment of production activity in manufacturing the last 3 months




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 8: Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë përpunuese
Capacity utilisation in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 9: Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese sipas degëve të industrisë përpunuese, 2002-2006
Capacity utilisation in manufacturing branches 2002-2006




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstileve dhe lëkure këpucëve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve
21-25 industria e letrës, plastikes, rafinimi i naftës
26 Fabrikimi i artikujve mineralje metalike
27-35 Metalurgjia, punimi me aleve, pajisje elek.

FIGURA 10: Vlerësimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë përpunuese
Assessment of production capacity in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 11: Parashikimi i çmimeve të shitjes në industrinë përpunuese
Assessment of selling prices in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 12: Parashikimi i punësimit në industrinë përpunuese
Employment expectations in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 13: Parashikimi i kontratave për export në industrinë përpunuese
Export expectation in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Vlerësimi i kapaciteteve prodhuese

Përgjigjet në lidhje me vlerësimin e kapaciteteve prodhuese në sektorin e industrisë përpunuese tregojnë se firmat kanë mundësi për të përballuar kontraktime të reja. Në prill 2006 drejtuesit e firmave të këtij sektori vlerësojnë kapacitetet e tyre prodhuese në 9 pikë. Në krahasim me tre muaj më parë kemi një rritje prej 11 pikësh në përqindje ndërsa krahasuar me një vit më parë ka një rënie prej 12 pikësh në përqindje të këtij treguesi. Ky tregues është më i ulët se mesatarja disavjeçare 2002-2005 me vetëm një pikë në përqindje.

Çmimet e shitjes

Balanca e përgjigjeve për mundësinë ose jo të rritjes së çmimeve të shitjes së produkteve në industrinë përpunuese është në nivelin e 0 pikëve. Kjo tregon se nuk parashikohet rritje çmimesh për tremujorin në vazhdim. Ritmet e rritjes së çmimeve të shitjes në këtë sektor po vinë duke u ulur dhe kjo për gati katër tremujore rresht (shiko figurën 11). Ky tregues ka një rënie prej tre pikësh në përqindje në krahasim me tre muaj më parë dhe një rënie prej 11 pikësh në përqindje po të krahasohet me të njëjtën periudhë një vit më parë. Nëse e krahasojmë me mesataren 2002-2005 shohim se ky tregues është 2 pikë në përqindje më i ulët.


Parashikimi i punësimit

Parashikimi i punësimit në sektorin e industrisë përpunuese mbetet në vlerë pozitive prej 13 pikësh. Ky nivel është 3 pikë më i lartë në përqindje se një tremujor më parë, ç'ka tregon se ritmet e punësimit në këtë sektor do të vijnë duke u rritur, së paku për tremujorin e dytë të këtij viti. Nga rezultatet e anketimit të fundit të biznesit del se parashikimi i punësimit ka pësuar një rënie prej 5 pikësh në përqindje në krahasim me një vit më parë dhe është 7 pikë në përqindje më e lartë se mesatarja 2002-2005. Treguesi i parashikimit të punësimit është gati në të njëjtat nivele nëse krahasohet me balancën në përqindje të dy viteve më parë.

Parashikimi i kontratave për export


Balanca e përgjigjeve në lidhje me parashikimin e kontratave për produktet e eksportit shënon një rënie prej 30 pikësh nga tremujori i parë i këtij viti. Ky nivel është 20 pikë nën mesataren 3 vjeçare, por ky tregues dhe për këtë tremujor vazhdon të mbetet në vlera pozitive. Treguesi i parashikimeve të kontratave për eksport në anketimin e fundit është 32 pikë në përqindje më i ulët se një vit më parë. Kjo tregon se eksportet përsëri nuk po balancojnë sa duhet mungesën e kontraktimeve në tregun e brendshëm në sektorin e industrisë përpunuese.

FIGURA 14: Vlerësimi i nivelit të kontraktiveve në industrinë përpunuese në 3 muajt e kaluar
Assesment of order-books in manufacture last 3 months




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 15: Pozicioni konkurrues në tregun e brendshëm në sektorin e industrisë përpunuese
Domestic competitive position in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 16: Pozicioni konkurrues në tregun e EU në sektorin e industrisë përpunuese
Foreign competitive position inside EU in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 17: Vlerësimi i nivelit të prodhimit në muaj në industrinë përpunuese
Assesment of months of production in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Niveli i kontraktiveve në 3 muajt e kaluar

Vlerësimi i nivelit të kontraktiveve në industrinë përpunuese në tre muajt e kaluar ka shënuar rënie duke kaluar në nivelet negative të 7 pikëve. Përkeqësimi i nivelit të kontraktiveve tregon për një klimë jo optimiste të biznesit në këtë sektor nga ana e drejtuesve në tremujorin e parë të 2006. Në krahasim me tre muajt më parë niveli i kontraktiveve ka rënë nga nivelet pozitive të 10 pikëve në atë të 7 pikëve në vlerë negative. Niveli i kontraktiveve është 8 pikë në përqindje më i ulët se mesatarja 2002-2005 ndërsa i krahasuar me prill 2005 ku ky tregues ka dhe vlerën më të ulët për të gjithë periudhën e anketimit është 21 pikë në përqindje më i lartë.

Pozicioni konkurrues në tregun e brendshëm

Nga anketimi i fundit i prill 2006 del se firmat prodhuese kanë përmirësuar pozicionin e tyre konkurrues në tregun e brendshëm me 10 pikë në përqindje krahasuar me tremujorin e parë të 2006 megjithëse krahasuar me mesataren trevjeçare ky tregues është 12 pikë në përqindje më i ulët. Konkurrueshmëria e firmave të sektorit të industrisë përpunuese në tregun e brendshëm është ulur me 4 pikë nëse e krahasojmë me të njëjten periudhë një vit më parë, por është 7 pikë më e lartë se i njëjti tregues i prill 2004.

Pozicioni konkurrues në tregun e EU-së

Nëse do të analizonim të njëjtin tregues por në lidhje me pozicionin konkurrues të firmave që operojnë në tregun e Bashkimit Europian do të vihej re një rënie e këtij treguesi në vlerën negative të 5 pikëve. Firmat e sektorit të industrisë përpunuese shënojnë një rënie prej gati 5 pikësh në përqindje të këtij treguesi nga tremujori i fundit ndërsa i parë në krahasim me mesataren 2002-2005 kjo rënie është me 6 pikë në përqindje. Nga të dhënat e anketimit të fundit pozicioni konkurrues i firmave prodhuese në tregun e Bashkimit Europian ruan gati të njëjtat nivele me një vit më parë por në krahasim me prill 2004 rënia është me 12 pikë në përqindje.

Vlerësimi i kontraktiveve në muaj


Niveli i kontraktiveve në muaj në sektorin e industrisë përpunuese për prill 2006 është mesatarisht me 9 muaj pune. Nga figura 17 shikohet se ky tregues është një muaj mbi mesataren 2002-2005 ndërsa e krahasuar me të njëjten periudhë një vit më parë është me një muaj më pak. Në krahasim me dy vjet më parë niveli i prodhimit në muaj në baze të anketimit të fundit është rritur me dy muaj pune. Niveli mesatar i prodhimit në muaj, në prill 2006, reflekton nivelet aktuale jo të mjaftueshme të kontraktiveve nga ana e ndërmarrjeve të sektorit të industrisë përpunuese dhe tregon për një rënie të parashikimeve për rritje të aktivitetit prodhues.

Pengesat në sektorin e industrisë përpunuese *Constraints within manufacturing sector*

Në prill 2006 **mangësitë e legjislacionit fiskal** janë zgjedhur nga 49% e të anketuarve, që do të thotë 6 pikë në përqindje më shumë se tre muaj më parë dhe 2 pikë në përqindje më pak se një vit më parë. Industria e fabrikimit të artikujve minerale jo metalike zë dhe përqindjen më të lartë për këtë pengesë në anketimin e fundit me 67% të përgjigjeve. **Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike** shënon dhe vlerën më të ulët historike për të gjithë periudhën e anketimit 2002-2006 duke treguar për një ndikim në rënie të kesaj


pengese në sektorin e industrisë përpunuese. Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve është industria ku kjo pengesë ka vlerën aktuale më të lartë me 74%. **Tregu informal** përbën në mënyrë të vazhdueshme një nga 2-3 faktorët më kufizues të aktivitetit të biznesit në vend. Në prill 2006, ky faktor përzgjidhet sërish nga 40 % e të anketuarve. Metalurgjia, punimi i metaleve, pajisjeve elektrike etj është industria që ka vlerën maksimale më të lartë në përqindje për këtë pengesë.

FIGURA 18: Ndikimi i keq zbatimit apo keq hartimit të legjislacionit fiskal në industrinë përpunuese
The impact of fiscal legislation in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 20: Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike në industrinë përpunuese
The impact of shortages on electricity in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 22: Ndikimi i tregut informal në industrinë përpunuese
The impact of informal sector in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 19: Ndikimi i keq zbatimit apo keq hartimit të legjislacionit fiskal sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of fiscal legislation in manufacturing branches




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve

FIGURA 21: Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of shortages on electricity in manufacturing branches



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve

FIGURA 23: Ndikimi i tregut informal sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of informal sector in manufacturing branches




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve

21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi i metaleve, pajisjeve elek.

Nga të dhënat e anketimit të fundit **mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar** si faktor kufizues në industrinë përpunuese ka shënuar një rënie me 6 pikë në përqindje nga tremujori i fundit. Kjo vlerë është 6 pikë në përqindje më e lartë se një vit më parë dhe 5 pikë në përqindje më e lartë se mesatarja e periudhës 2002-2005. Në prill 2006 ky faktor pengues në industrinë e veshjes dhe fabrikimit të këpucëve është 70 pikë në përqindje. **Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brenda vendit** është një pengesë konstante në sektorin e industrisë përpunuese. Në anketimin e fundit të prill 2006, 37% e të anketuarve për


mendin mungesën e kërkesës së brëndshme si një prej kufizimeve kryesore të aktivitetit të tyre prodhues. Fabrikimi i artikujve prej druri, dhe mobiljeve duket se është industria që e ndjen më shumë peshën e kesaj pengese me 72% te vleres aktuale. Në bazë të përgjigjeve të fundit të anketimit **kërkesa e pamjaftueshme nga tregu i jashtëm** është 10 pikë në përqindje më e lartë se tre muaj më parë por është 6 pikë në përqindje më e ulët se e njëjta periudhë një vit më parë. Kjo pengese ka vleren maksimale në përqindje prej 65% në industrinë e letrës, plastikës, rafinimit të naftës etj.

FIGURA 24: Ndikimi i mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar në industrinë përpunuese
The impact of shortages of skilled labor force in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 26: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brëndsa vendit
Insufficient domestic demand in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe zhvillim, Tiranë

FIGURA 28: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm
Insufficient foreign demand in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 25: Ndikimi mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of shortages of skilled labor force in manufacturing




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve
21-25 industria e letrës, plastikës, rafinimi i naftës
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalikë
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elektronikë

FIGURA 27: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brëndsa vendit sipas degëve të industrisë përpunuese
Insufficient domestic demand in manufacturing branches



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve
21-25 industria e letrës, plastikës, rafinimi i naftës
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalikë
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elektronikë

FIGURA 29: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of Insufficient foreign demand in manufacturing branches




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve
21-25 industria e letrës, plastikës, rafinimi i naftës
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalikë
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elektronikë

Vështirësitë për të siguruar kredi janë përmendur nga 13% e drejtuesve të firmave prodhuese në prill 2006. Në krahasim me një vit më parë kjo vështirësi në këtë sektor është rritur me 7 pikë në përqindje ndërsa e krahasuar me dy vjet më parë me vetëm 4 pikë. Industria e fabrikimit të artikujve minerale jo metalike ka vlerën më të lartë të kësaj pengese me 72 pikë në përqindje. **Korrupsioni në organet tatimore** është zgjedhur nga 24% e firmave të anketuara duke pësuar një rritje prej 12 pikësh në përqindje nga tremujori i fundit. Megjithëse kjo pengesë është me 4 pikë në përqindje më e ulët se mesatarja 2002-2005 ajo vazhdon të jetë një vështirësi e konsiderueshme në këtë sektor. Ky faktor përmendet nga shumica e degëve të industrisë përpunuese megjithëse vlerën aktuale më të lartë në anketimin e fundit e ka indus


tria e fabrikimit të artikujve prej druri, mobiljeve etj me 41%. Vlerën maksimale të kësaj pengese e shënon industria e fabrikimit të artikujve minerale jometalike me 82 pikë në përqindje. **Konkurrenca nga importet** ka rënë me 2 pikë në përqindje nga tremujori i fundit dhe 10 pikë në përqindje krahasuar me një vit më parë. Nga mesatarja trevjecare konkurrenca nga importet është vetëm 2 përqind më e ulët. Industria e fabrikimit të artikujve minerale jo metalike ka vlerën maksimale prej 82% të kësaj pengese, gjithashtu dhe vlerën aktuale më të lartë me 39%. Kjo pengesë ka një ndikim të ulët në industrinë e fabrikimit të artikujve prej druri dhe mobiljeve ku vlera aktuale është vetëm 11 pikë në përqindje.

FIGURA 30: Vështirësitë për të siguruar kredi në sektorin e industrisë përpunuese
Difficulties in obtaining credit in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 32: Ndikimi i korrupsionit në sektorin e industrisë
The impact of corruption in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 34: Konkurrenca nga importet në sektorin e industrisë përpunuese
Competitive imports in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 31: Vështirësitë për të siguruar kredi sipas degëve të industrisë përpunuese
Difficulties in obtaining credit in manufacturing branches




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek.

FIGURA 33: Ndikimi i korrupsionit sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of corruption in manufacturing branches



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek.

FIGURA 35: Konkurrenca nga importet sipas degëve të industrisë përpunuese
Competitive imports in manufacturing branches



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek.

SEKTORI I NDERTIMIT

CONSTRUCTION SECTOR

Klima e biznesit

Në prill të vitit 2006 klima e biznesit në sektorin e ndërtimit paraqet përmirësim në krahasim me 3 muajt më parë, por duke mbetur në vlera negative. Ky përmirësim i situatës në këtë tremujor është rrjedhojë e vlerësimeve në rritje të treguesit të punësimit në 3 muajt e ardhshëm.

Treguesi i besueshmërisë në sektorin e ndërtimit paraqitet më e ulët se një vit më parë, gjë që tregon se ky vit nuk ka filluar mbarë për sektorin e ndërtimit. Në muajin prill 2006 treguesi i besueshmërisë së QKZH-së në sektorin e ndërtimit shënon vlerën e -5 pikëve. Ky nivel është 9 pikë më i ulët krahasuar me një vit më parë (prill 2005), por është në të njëjtin nivel sa dhe mesatarja 2002 – 2005.

Niveli i kontraktiveve

Treguesi mbi nivelin aktual të kontraktiveve në muajin prill shënon vlerën e -24 pikëve (figura 37). Kjo vlerë është vetëm me një pikë ndryshimi nga tremujori i kaluar. Krahasuar me një vit më parë ka një rënie prej 13 pikësh, ndërsa krahasuar me mesataren është 5 pikë më e ulët nga mesatarja 2002 - 2005 e këtij treguesi, gjë që vazhdon të shprehë një nivel jo të kënaqshëm në nivelin aktual të kontraktiveve.


Parashikimi i punësimit

Parashikimi i punësimit për 3 muajt e ardhshëm në sektorin e ndërtimit shënon një pikë kthese. Në prill të 2006 firmat ndërtuese parashikojnë një rritje të punësimit ndryshe nga tremujori i kaluar. Ky tregues është vlerësuar me 13 pikë në përqindje në këtë tremujor (figura 38). Kjo vlerë është 12 pikë në përqindje më e lartë se tremujorin e kaluar por 7 pikë në përqindje më e ulët se një vit më parë, prill 2005. Në krahasim me mesataren disa vjeçare (2002-2005) treguesi i parashikimit të punësimit është 5 pikë në përqindje më e lartë.

Aktiviteti i prodhimit në 3 muajt e kaluar


Aktiviteti i prodhimit në 3 muajt e kaluar vazhdon të deklarohet në rënie edhe për këtë tremujor duke mbetur në vlera negative. Nga figura 39 vihet re se në muajin prill 2006 balanca e përgjigjeve të manaxherëve të firmave të ndërtimit mbi situatën në aktivitetin e ndërtimit në 3 muajt e kaluar është në vlerën prej -13 pikë. Kjo vlerë është 4 pikë në përqindje më e ulët se 3 muajt më parë. Ky nivel krahasuar me prill 2005 është 2 pikë në përqindje më i lartë, ndërsa krahasuar me dy vjet më parë është 9 pikë në përqindje më i ulët.

FIGURA 36: Treguesi i besueshmërisë së QKZH-së në sektorin e ndërtimit
CRD confidence indicator in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 37: Vlerësimi i nivelit të kontratave në sektorin e ndërtimit
Assessment of order-books in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 38: Parashikimi i punësimit për 3 muajt e ardhshëm në sektorin e ndërtimit
Employment expectation in construction sector (next 3 months)



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 39: Vlerësimi i aktivitetit të ndërtimit në 3 muajt e fundit
Assessment of business activity in the last 3 months in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë


Çmimet në ndërtim

Balanca e përgjigjeve në lidhje me çmimet e ndërtimit vazhdon të mbetet pozitive, si për të tërë periudhën prill 2002 – prill 2006 të kryerjes së anketimeve nga Qendra për Kërkim dhe Zhvillim. Kështu, treguesi i çmimeve është pozitiv prej 37 pikësh. Megjithëse është 2 pikë në përqindje më pak se në tremujorin e kaluar, mbetet 4 pikë në përqindje më shumë se mesatarja disavjeçare (figura 40). Kjo tregon që do të vazhdojë rritja e çmimeve të ndërtimit pothuajse me të njëjtat ritme.

Niveli i kontraktimeve në muaj


Niveli i kontraktimeve në muaj në sektorin e ndërtimit vlerësuar në muajin prill 2006 është mesatarisht 8 muaj. Krahasuar me një tremujor më parë kjo vlerë është mesatarisht 1 muaj më pak, sikurse e krahasuar edhe me prill 2005. Niveli mesatar i kontraktimeve është në rënie për të dytin tremujor në vazhdim, duke ritheksuar shqetësimin e drejtuesve të firmave ndërtuese mbi pamjaftueshmërinë e kontratave të lidhura.

FIGURA 40: Parashikimi i çmimeve në sektorin e ndërtimit
Price expectations in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 41: Vlerësimi i nivelit të kontraktimeve në muaj në sektorin e ndërtimit
Work already contracted in months in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Pengesat në sektorin e ndërtimit *Constraints within construction sector*


Proçedurat për leje ndërtimi

Ndikimi i proçedurave për leje ndërtimi vazhdon të konsiderohet si faktori më kryesor pengues nga ndërtuesit edhe për këtë periudhë. Në prill 2006, 61% e të anketuarve e kanë përmendur këtë faktor si një nga pengesat e tyre (shiko figurën 42). Kjo vlerë është 3 pikë në përqindje më e lartë se janar 2005 por 9 pikë në përqindje më e ulët se një vit më parë, prill 2005. Ndikimi kufizues i proçedurave për leje ndërtimi është më i theksuar për firmat e ndërtimit që operojnë në Tiranë. Më pak kufizuese kjo pengesë është për firmat e ndërtimit në rrethin e Vlorës.

Energjia elektrike


Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike në sektorin e ndërtimit mbetet një nga tre pengesat kryesore në aktivitetin e ndërtimit, megjithëse me një rënie të ndjeshme krahasuar me tremujorin e kaluar. Në anketimin e prill 2006, 36% e drejtuesve të firmave të ndërtimit shprehin problem të tyrin edhe kufizimet e energjisë elektrike, vlerë e cila ka një rënie prej 20 pikësh në përqindje krahasuar me janar 2006. Kjo vlerë është më e ulët edhe se vlera e shënuar një vit më parë, prill 2005, me 16 pikë në përqindje. Mungesa e energjisë elektrike është më shumë e ndjeshme në rrethin e Shkodrës.

FIGURA 42: Ndikimi i proçedurave për leje ndërtimi
Building licensing procedures in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 43: Ndikimi i mungesave të energjisë elektrike në sektorin e ndërtimit
The impact of shortages on electricity in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 44: Ndikimi i legjislacionit fiskal në sektorin e ndërtimit
The impact of financial legislation in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 45: Konkurrencë e pandershme nga tregu i zi në sektorin e ndërtimit
Unfair competition by black market in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 46: Ndikimi i faktorëve makroekonomikë në sektorin e ndërtimit
The impact of macroeconomic factors in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 47: M os zbatim korrekt i ligjit të prokurimit në sektorin e ndërtimit
Not correct implementation of the procurement law in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Legjislacioni fiskal

Legjislacioni fiskal i keq-hartuar apo keq-zbatuar përmendet edhe ky si një nga tre faktorët më pengues në veprimtarinë ndërtuese të firmave të ndërtimit. Në prill 2006 kjo pengesë është theksuar nga 54 % e të anketuarve, vlerë kjo e njëjtë me atë të marrë nga anketimet e tremujorit të kaluar dhe e njëjtë edhe me vlerën e mesatares së 2002 - 2005. Krahasuar me prill 2005, kjo vlerë është 23 pikë në përqindje më e ulët.

Aktiviteti informal

Aktiviteti informal është një faktor në sektorin e ndërtimit, i cili vazhdon të ulë ndikimin e tij negativ si faktor pengues në këtë sektor për të dytin tremujor rresht. Nga anketimi gjatë muajit prill 2006, rezulton se 23 % e të anketuarve e kanë përmendur atë si faktor pengues, vlerë kjo 3 pikë në përqindje më e ulët se tremujorin e kaluar dhe 34 pikë në përqindje më pak se një vit më parë. Figura 45 tregon se në prill 2006 shënohet vlera më e ulët historike për periudhën prill 2002 – janar 2006 për këtë faktor.

Faktorët makroekonomike

Ndikimi i faktorëve makroekonomike (si lëvizjet e shpeshta të kursit të këmbimit, por edhe paqëndrueshmëria politike) është përmendur nga vetëm 6% e drejtuesve të firmave të ndërtimit në anketimin e fundit të janar 2006, duke pësuar një rënie prej 5 pikë në përqindje krahasuar me janar 2006. Kjo shifër tregon se faktorët makroekonomikë, nga faktorë pengues me ndikim më të madh kufizues në këtë sektor, kanë kaluar në krahun e faktorëve pengues me më pak peshë, si mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar (2%) apo e paisjeve të pështatshme (0%), sigurimi i kredive (3%), etj. Nga figura 46 duket se vazhdon një rënie e peshës kufizuese të faktorëve makroekonomike në këtë sektor për të tretin tremujor në vazhdim. Krahasuar me një vit më parë kemi një rënie me 4 pikë në përqindje. Vlera e shënuar për prill 2006 është dhe vlera më e ulët historike për anketimet e kryera në 2002 -2006.

Zbatimi i ligjit të prokurimit

Zbatimi jo korrekt i ligjit të prokurimit është një faktor pengues në rritje për tremujorin e dytë të 2006. Në prill 2006, 25 % e ndërtuesve janë përgjigjur me ‘po’ kësaj pengese, ndaj 20 % të tyre në janar 2006. Ky faktor është më i ndjeshëm në rrethin e Elbasanit dhe Fierit, më pak i ndjeshëm në Tiranë dhe aspak kufizues për firmat e ndërtimit të anketuara në rrethin e Vlorës. Pavarësisht rritjes që ka pësuar në krahasim me tremujorin e kaluar, vlera e marrë në këtë tremujor është 8 pikë në përqindje më e ulët se prill 2005.

TË PËRGJITHSHME

Gjatë anketimit të muajit prill 2006 u kontaktuan rreth 550 firma në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit në rrethet Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan dhe Shkodër,

Anketimi i biznesit në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit ka filluar në muajt janar dhe prill të vitit 2002. Anketimi bazohet mbi vlerësimin cilësor të opinionëve të menaxherëve apo pronarëve të ndërmarrjeve të kontaktuara. Vlerësimet cilësore përpunohen në formën e treguesit të Balancës, e cila shpreh diferencën midis përgjigjeve optimiste (në rritje, apo përmirësim) kundrejt atyre pesimiste (në ulje, apo përkeqësim) duke përjashtuar nga vlerësimi opinionet që shprehin situatë të pandryshuar. Në këtë mënyrë kur balanca e përgjigjeve është pozitive vlerësimet e optimistëve tejkalojnë ato të pesimistëve dhe në të kundërtën do të kishim një balancë negative. Klima e biznesit vlerësohet nëpërmjet indikatorit të besueshmërisë. Ky indikator për sektorin e industrisë përpunuese llogaritet si mesatare aritmetike e tre indikatorëve: parashikimit të prodhimit, vlerësimin e kontratave të realizuara, dhe vlerësimin e produktit të gatshëm (i marrë me shenjë të kundërt). Për sektorin e ndërtimit indikator i besueshmërisë llogaritet si mesatare aritmetike e treguesit mbi vlerësimin e kontraktiveve aktuale dhe parashikimit të punësimit.

QENDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM

QKZH është një organizatë jo fitimprurëse dhe jo partiake e regjistruar në Gjykatën e Tiranës më 27/03/2001. Qëllimi i QKZH është kryerja e studimeve dhe analizave ekonomike rreth zhvillimeve dhe performancës së biznesit nëpërmjet anketimeve periodike. Duke analizuar problematikat e biznesit dhe publikut dhe shpërndarjen e rezultateve synohet të ndihmohen institucionet publike dhe komuniteti i biznesit për të përcaktuar politika më të mira që i shërbejnë përmirësimit të jetës të të gjithë qytetarëve.

Drejtoresha Ekzekutive/ *Executive Director*:
Mirlinda Rusi (Gajo)

Anëtarët e grupit / *Group's members*
Jonida Naska
Rozi Poga (Beqiri)
Bexhet Hyka

Duke ndjekur të njëjtën praktikë për periudha rigorozisht të përcaktuara (mujore apo tremujore), mbi bazën e balancave ndërtohen indikatorë të caktuar të biznesit që shprehin situatën e biznesit në raport me periudhat e mëparshme, situatën aktuale dhe parashikimin për një periudhë të paktën 3 mujore. Anketimet e biznesit shërbejnë, gjithashtu, jo vetëm për të ndjekur tendencën e biznesit, por me anë të tyre diktohen ciklet e biznesit, si dhe pikat e kthesës në ciklin e biznesit. Kjo metodë anketimi zbatohet në të gjitha vendet e Bashkimit Europian dhe vendet Kandidate, si dhe me pak ndryshime në të gjitha vendet anëtare të OECD-së. Në Evropë, një nga institutet më prestigjioze që ka filluar anketimet cilësore të biznesit është KOF Instituti Zvicerian për Analizën e Ciklit të Biznesit në Zyrih, Zvicër (viti 1955). Stafi teknik i QKZH-së në periudhën 8 -12 qershor 2005 ka marrë pjesë në tavolinat e punës të organizuara nga KOF posaçërisht për rritjen e kapaciteteve teknike të saj në fushat specifike si: hartim metodologjie për përzgjedhjen e kampionit në sektorët e industrisë përpunuese dhe ndërtimit për Shqipërinë; analizë ekonomike për interpretim të rezultateve në lidhje me tendencën e biznesit dhe vlerësimin e indikatorëve sintetike; implementim teknik të tendencave sipas anketimit në bizneset industri përpunuese dhe ndërtim.

CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

CRD Tirana is an independent, non-profit and non-partisan organisation, duly registered at the Court of Tirana in 27.03.2001. The aim of CRD is to create and disseminate knowledge about economic development and business performance to help public institutions and business community to designate good policies for a better society. The CRD conducts business and consumer surveys, organises meetings and publish research results about recent business development, factors limiting production activity and future investment.